



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 859/2 Prot.

Tiranë, më datë 08.07.2022

VENDIM

Nr. 331, datë 01.07.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.07.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të rishikuar “Ndërtimi i Bypass-it në Qendrën Historike (Ura e Nanxës - Urat e Mëdha Dunavat) – projekti i rishikuar”, me aplikues Blerina Duka dhe zhvillues Bashkia Gjirokastrë, me devijimet përkatëse të trasesë së Bypassi-it të Gjirokastrës, në segmentin pranë Urës së Mesit dhe Urës së Dunavatit;
2. Miratimin e projektit të restaurimit për “Urën e Mesit, Gjirokastrë”, pjesë e pasurisë kulturore “Tri urat e vogla mbi përroin e Zerzebit”, zbatimi i punimeve të së cilës, të kryhet përpara vijueshmërisë së punimeve të Bypass-it;
3. Projekti të dërgohet për opinion pranë UNESCO-s;
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
7. mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
8. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

